



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 2 Regj.Them.

Nr. 2 VENDIMI

Datë 24.02.2023 Regj.Them

Datë 09.03.2023 VENDIMI

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare:	Emona MUÇI	<i>(Relatore)</i>
Gjyqtare:	Edlira PETRI	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtare:	Blerona HASA	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtare:	Marsela DERVISHI	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtar:	Sokol IBI	<i>(Anëtar)</i>

me sekretare gjyqësore *Ermelinda Nuraj*, sot më datë **09.03.2023**, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr. **2** akti, datë **24.02.2023** që i përket:

PADITËS: **Partia Bindja Demokratike**, përfaqësuar nga z. Fabian Topollari përfaqësues i përhershëm i Partisë Bindja Demokratike pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, autorizuar nga Bordi Drejtues i Partisë Bindja Demokratike.

IPADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar në gjykim me autorizim me nr. 1481 Prot., datë 08.03.2023 nga Z.Erdal Mema.

OBJEKTI: Anullimin e vendimit të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve nr. 07, datë 25.01.2023, për shqyrtimin e kërkesës nr 04, datë 14.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE:

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”; i ndryshuar, Kodi i Procedurave Administrative, i ndryshuar; nenet 23 dhe 23/4, pika 1 dhe 4, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar.

KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR

në seancën e datës **09.03.2023**, pasi dëgjoji pretendimet e fundit të palës paditëse që kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, si dhe palës së paditur që kërkoi rrëzimin e padisë,

VËREN:

1. Se pala paditëse, subjekti **Parti Partia Bindja Demokratike** i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, padinë me objekt *“Anullimin e vendimit të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve nr. 07, datë 25.01.2023, për shqyrtimin e kërkesës nr 04, datë 14.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”*.
2. Nga aktet e dosjes rezulton se më datë 24.02.2023 pala paditëse ka paraqitur kërkesë padinë pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nëpërmjet shërbimit postar (*dorëzuar në postë më datë 23.02.2023*), brenda afatit ligjor 30-ditor të parashikuar në nenin 152 të Kodit Zgjedhor.
3. Kërkesë padia rezulton të jetë paraqitur në respektim të plotë të formës dhe të paraqitjes së saj, kritere këto të përcaktuara në nenin 153 të Kodit Zgjedhor.
4. Referuar përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, brenda afatit ligjor, u caktua seanca për gjykimin e kërkesëpadisë së paraqitur, duke iu kërkuar edhe palës së paditur paraqitja e të gjithë dokumentacionit përkatës, lidhur me vendimmarrjen që kundërshtohet nëpërmjet kësaj kërkesëpadie.

I. FAKTET E CËSHTJES:

5. Pala paditëse/ subjekti Partia "Bindja Demokratike" është parti politike në Shqipëri regjistruar në 23 prill 2019, që i përket spektrit politik të qendrës së djathtë, koordinatori i saj është z. Astrit Patozi.
6. Pala e paditur/Komisioni Qendror i Zgjedhjeve/palë e paditur, ka autoritetin dhe përgjegjësinë të mbikëqyrë, të kontrollojë dhe të auditojë fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, gjatë dhe jashtë periudhës së fushatës zgjedhore, si edhe të hartojë aktet nënligjore në zbatim të Kodit Zgjedhor dhe ligjit *“Për Partitë Politike”*.

7. Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin, me përfundimin e të cilave partitë politike pjesëmarrëse kanë raportuar lidhur me përdorimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara gjatë procesit zgjedhor.
8. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.04.2021, dhe me vendimin nr. 224, datë 07.12.2022 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021” është vendosur: *“1. Miratimin e gjetjeve të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. 2. ...13. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Bindja Demokratike” me gjobë në masën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor. ...83. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. 84. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes.*
9. Me kërkesën nr. 04, datë 14.12.2022, nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i është kërkuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) vendosja e sanksionit administrativ me gjobë, për shkelje të dispozitave të nenit 173, të Kodit Zgjedhor për një numër subjektsh zgjedhore, mes të cilëve edhe për paditësin si vijon: *“...Partia Bindja Demokratike – Nuk ka dorëzuar raportet për 153 (njëqind e pesëdhjetë e tre) kandidatë të listave shumëmbrore duke mos respektuar vendimin nr. 13, datë 6 prill 2021, të Komisionit Rregullator dhe për këtë arsye nuk janë audituar raportet e kandidatëve, si dhe nga konstatimet e KRIIK rezulton se 12 (dymbëdhjetë) nga këto kandidat kanë pasur shpenzime për reklama politike në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram.”*
10. Referuar nenit 173, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja dënohet me gjobë në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) deri 1 000 000 (një milion) lekë. ...
11. Në përfundim të shqyrtimit të raporteve të auditimit të dorëzuara nga subjektet zgjedhore, duke marrë në konsideratë problematikat e evidentuara dhe të referuara vendimit nr. 224, datë 07.12.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike

pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”, dhe në mbështetje të neneve 19, shkronja “c” dhe nenit 173, pikat 1,3,5,8,9 të Kodit Zgjedhor, nenit 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, propozoi të vendosen masat e sanksionit administrativ më gjorbë, për shkelje të dispozitave të nenit 173, të Kodit Zgjedhor, për subjektet zgjedhore listuar si më poshtë: ... “ T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Bindja Demokratike” me gjorbë në masën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor; ... Marzhi minimal i sanksionit të propozuar për secilin subjekt, bazohet në faktin se subjektet zgjedhore të mëposhtëm nuk rezultojnë të jenë përsëritës.

12. Në vijim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i është drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, me kërkesën nr. 4, datë 14.12.2022 për vendosje sanksioni administrativ për shkeljet e konstatuara nga subjekte zgjedhore për zgjedhjet e Kuvendin e Shqipërisë, datës 25.04.2021 ku është edhe pala paditëse.
13. Në seancën e datës 16.01.2023, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mori në shqyrtim kërkesën e Komisionerit, në prani të përfaqësuesve të palëve të interesuara, disa parti politike.
14. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në përfundim të hetimit administrativ, ka disponuar me vendimin nr. 7, datë 25.01.2023, bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja ‘dh’, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vendosi:
15. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve me vendim nr. 07, datë 25.01.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës nr. 04, datë 14.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, ka vendosur: “1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksioneve administrative ndaj subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve për shkelje lidhur me raportimin financiar. 2. Vendosjen e sanksionit administrativ në masën 500.000 (pesëqindmijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” për subjektet zgjedhore: -... -Bindja Demokratike; ...9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. 10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ, Tiranë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij.
16. **Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve** ndër të tjera në vendimmarrjen e saj ka arsyetuar se:(...)...*Tipologjia e shkeljeve të konstatuara nga Komisioneri për 14 subjekte zgjedhore dhe 1 kandidat, për të cilët kërkon vendosjen e sanksionit administrativ përmbledh mosdorëzimin e raporteve të të ardhurave dhe shpenzimeve nga një numër kandidatësh të subjekteve, mosbashkëpunimin ose refuzimin për të bashkëpunuar me KQZ-në lidhur me raportimin, mungesën e dokumentacionit shoqërues për shpenzimet,*

raportimin jo sipas formatit të standardizuar si dhe kapërcimin e limiteve ligjore në kryerjen e shpenzimeve dhe pranimin e donacioneve.

16.1 *Palët e interesuara pjesëmarrëse në seancë ngritën dy pretendime kryesore për të justifikuar shkeljet e konstatuara, pretendimin se mungesa e raportimeve për kandidatët vjen për shkak se kandidatët nuk kanë pasur shpenzime (në rastin e partisë politike “Nisma Thurja”, për shkak se nuk kanë kryer fushatë), si dhe pretendimin se për partitë pjesëmarrëse në koalicion nuk mund të vendosen sanksione administrative, sa kohë që detyrimi për raportim i takon partisë udhëheqëse të koalicionit Trajtimi i këtyre pretendimeve ka shumë rëndësi për zbatimin e rregullt dhe uniform të Kodit Zgjedhor.*

16.2 *Fushata zgjedhore është e lidhur pazgjidhshmërisht me kryerjen e shpenzimeve për veprimtaritë në fushatë. Të gjitha veprimtaritë kanë kosto, e cila duhet të evidentohet dhe të raportohet si shpenzim si kur mbulohet nga vetë kandidati ose subjekti zgjedhor nga të ardhurat e veta, si kur mbulohet nga financimi buxhetor, si kur mbulohet nga donacionet në të holla ose në natyrë. Kodi Zgjedhor ka adoptuar një mekanizëm pariteti proporcional dhe mbështetjeje financiare për subjektet elektorale, me qëllimin që të lehtësojë barrën e shpenzimeve dhe ta bëjë garën sa më të barabartë. Por, që të ruhet barazia në konkurrim duhet që kontrolli dhe mbikëqyrja e zbatimit të rregullave për financimin e fushatës të jetë i hollësishëm dhe i rreptë. Për këtë arsye ka shumë rëndësi që raportimi, rregullshmëria, saktësia dhe vërtetësia e tij të jenë të garantuara dhe të pacenueshme.*

16.3 *Shkeljet në raportim, fshehja e të ardhurave dhe shpenzimeve, cenimi i kufijve ligjorë lidhur me masën e të ardhurave dhe shpenzime përbëjnë, në këndvështrim të Kodit Zgjedhor, kundravajtje të rënda. Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor kanë synuar pikërisht forcimin e disiplinës financiare dhe transparencën e raportimit, në mënyrë të veçantë nëpërmjet forcimit të sanksioneve. Kjo rreptësi duhet të karakterizojë edhe KQZ-në në trajtimin e këtyre rasteve. KAS-i çmon se pretendimi për fushatë të kandidatëve “pa shpenzime” është një pretendim jo real, i cili mund të vijë nga padija, paaftësia për të ruajtur disiplinë financiare apo për të organizuar siç duhet punën, por mund të vijë edhe si tentativë për mosraportim të saktë, për fshehje apo devijim të një pjese të të ardhurave dhe shpenzimeve në kanale informale, apo si shmangie nga tavanet ligjore etj. Pavarësisht nga motivet, pretendimi për kandidatë “pa shpenzime” nuk mund të pranohet nga KAS-i, sepse një pretendim i tillë është de facto i pavërtetë.*

16.4 *Në themel të zgjedhjeve demokratike qëndron parimi i konkurrueshmërisë. Makina administrative e zgjedhjeve ngrihet dhe mbahet në këmbë pikërisht për t’i shërbyer këtij parimi. Parimi i konkurrueshmërisë kërkon që të mos ketë kufizime në të drejtën për të marrë pjesë në garë dhe që garuesit të jenë të barabartë me njeri tjetrin. Kushtet dhe kriteret e vendosura për t’u plotësuar nga subjektet zgjedhore janë proporcionale dhe nuk e çenojnë konkurrueshmërinë. Prandaj respektimi ose jo i tyre nga subjektet dhe kandidatët nuk mund të trajtohet si çështje e vulletit të tyre të lirë dhe as si taktikë individuale zgjedhore. Kandidatët që regjistrohen në zgjedhje, regjistrohen për të marrë pjesë në garë.*

16.5 *Praktika zgjedhore mund të njohë raste kur kandidatë të veçantë mund të mos zhvillojnë dot veprimtari fushate, por ky rast mund të pranohet vetëm si rast përjashtimor dhe që vjen për shkaqe madhore. Një nga kushtet e vendosura për subjektet zgjedhore për të marrë pjesë është ai i plotësimit të listave shumemërore në bazë qarku. Neni 67 i Kodit Zgjedhor kërkon që “numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy”. Ky kusht i shërben ruajtjes në çdo rast të funksionalitetit të organit të zgjedhur dhe garantimit të paritetit gjinor. Ky kusht përbën conditio sine qua non për partinë politike që kërkon të marrë pjesë në garë. Por kjo nuk do të thotë, se kushti mund të anashkalohet duke dorëzuar lista kandidatësh jo reale, të mbushur me emra individësh që nuk e ndejnë, nuk duan ose, që nuk kanë nevojë të marrin pjesë në garë.*

16.6 *Plotësimi fiktiv i listave të kandidatëve, me qëllimin që një ose disa kandidatë të marrin pjesë në garë me formatin e një partie politike është praktikë e kundërligjshme zgjedhore, sepse cenon parimin e konkurrueshmërisë dhe barazinë e palëve në garë. Kandidimi i një ose disa kandidatëve të së njëjtës përkatësi është i mundur sipas Kodit Zgjedhor, pa pasur nevojë për plotësimin formal/fiktiv të kushtit të nenit 67 të Kodit për numrin e kandidatëve në listë. Ai realizohet me mekanizimin e kandidatëve të pavarur, për të cilët veprojnë kushte dhe kritere të tjera. Nëse një parti e vogël politike zgjedh me vetëdije konkurrimin si parti në zgjedhje, atëherë ajo duhet të pranojë dhe respektojë të gjitha kushtet dhe kriteret e vendosura nga Kodi për partitë politike, përndryshe i takon të përballet me pasojat që Kodi ka parashikuar për kundërvajtjen. Për këto arsye, KAS-i e gjen me vend që t’ a rrëzojë pretendimin e paraqitur për mosraportim të kandidatëve “për shkak se nuk kanë pasur shpenzime, nga që nuk kanë bërë fushatë”.*

16.7 *Kandidimi fiktiv është në kundërshtim të hapur me qëllimin e zgjedhjeve dhe parimet mbi të cilat zhvillohen ato, prandaj KAS-i nuk mund ta legjitimojë këtë praktikë. Pretendimi tjetër i rëndësishëm ishte pretendimi i ngritur nga një pjesë e palëve të interesuara, se, sa i takon koalicionëve, detyrimet dhe përgjegjësitë për raportimin i takojnë partisë udhëheqëse të koalicionit dhe partitë pjesëmarrëse në koalicion nuk mund të penalizohen për mangësi në raportim, sa kohë që për to mungon detyrimi për raportim. Partia udhëheqëse e koalicionit duhet të përgjigjet përpara KQZ-së dhe eventualisht të penalizohet për mospërbushje të detyrimeve në raportim, në emër dhe për llogari të të gjitha partive pjesëmarrëse.*

16.8 *Pretendimi mbështetëj në leximin, nga ky pozicion, të fjalisë së dytë të pikës 3, të nenit 65 të KZ: “Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit”. Çështja e transferimit të të drejtave dhe detyrimeve tek partia udhëheqëse e koalicionit është trajtuar nga KAS-i në vendimin e tij nr. 20, datë 05.04.2021 dhe nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor në vendimin e tij nr.8, datë 19.04.2021. Këto vendime kanë pasur në fokus të drejtën e partisë politike pjestare të koalicionit për të propozuar anëtarët e GNV-ve. Në këtë rast, si KAS-i ashtu dhe KZGJ-ja kanë mbështetur leximin, se qenia e një partie*

pjestare në një koalicion e zhvesh atë nga të drejtat dhe detyrimet që i takojnë sipas Kodit Zgjedhor. “Detyrimi i vendosur nga neni 65, paragrafi 3 i Kodit Zgjedhor nuk mund të konsiderohet i përmbushur vetëm me përcaktimin e një partie udhëheqëse të koalicionit, nëse kjo parti nuk do të kishte një “status të veçantë” në krahasim me partitë e tjera. Pra, me vullnetin e tyre të lirë partitë politike zgjedhin mes tyre atë udhëheqëse, në mënyrë që kjo e fundit të ushtrojë në emër dhe për interes të të gjitha partive pjesëtare të koalicionit, të drejtat dhe detyrimet që i njihen çdo subjekti politik pjesëmarrës në zgjedhje” (Vendimi i KAS-it nr. 20, datë 05.04.2021).

16.9 *Përtej qendrimit të mbajtur me vendimin nr.20, datë 05.04.2021, KAS-i konstaton se detyrimi për raportimin financiar nuk formon një rregullim sui generis në Kodin tonë Zgjedhor, i cili të përjashtojë zbatimin e paragrafit 3, të nenit 65 në rastin e raportimit financiar. Thënë këtë, KAS-i çmon se vendimi i tij nr. 20, datë 05.04.2021 ka nevojë të rivizitohet në rastin objekt shqyrtimi, me qëllim që të shmangen keqkuptimet, të sqarohet më mirë pozita juridike e partisë udhëheqëse dhe e partisë pjesëmarrëse në koalicion, si dhe të ndahen saktësisht përgjegjësitë.*

16.10 *Qëllimi i paragrafit 3 të nenit 65 të Kodit Zgjedhor nuk është përcaktimi i një pozite të privilegjuar të partisë udhëheqëse të koalicionit në raport me partitë pjesëmarrëse të tij. Fjalja “për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit” ka qëllim vetëm të përcaktojë partinë udhëheqëse të koalicionit si pikë kontakti dhe interlokutor të KQZ-së, në emër dhe për llogari të koalicionit. Nuk është qëllim i Kodit dhe nuk ka kuptim që të pretendohet se themelimi i koalicionit “asgjëson” partitë pjesëmarrëse të tij (të drejtat e tyre) dhe mban në këmbë vetëm partinë udhëheqëse. Partitë pjesëmarrëse konkurrojnë në zgjedhje, sikurse bën edhe partia udhëheqëse. Të drejtat dhe detyrimet e tyre nuk shuhen. Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve nga partitë pjesëmarrëse tek partia udhëheqëse nuk vjen për shkak të fjalisë së dytë të paragrafit 3 të nenit 65, nuk vjen ipso lege, por vjen për shkak të fjalisë së tretë të tij, e cila përcakton se “marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ”. Është marrëveshja e koalicionit ajo që bën transferimin e të drejtave dhe detyrimeve tek partia udhëheqëse. Për këtë shkak, marrëveshja e koalicionit duhet të formojë jo vetëm autorizimin për partinë udhëheqëse të koalicionit për përfaqësim, por duhet edhe të vendosë modalitetet, procedurat dhe kufijtë e këtij përfaqësimi, duhet të vendosë përgjegjësitë dhe detyrimet e partisë udhëheqëse ndaj partive pjesëmarrëse në koalicion. Vetëm mbi këtë bazë mund të kryhet ushtrimi “në emër dhe për llogari” i të drejtave dhe përmbushja “në emër dhe për llogari” e detyrimeve nga ana e partisë udhëheqëse të koalicionit.*

16.11 *Fjalja e dytë dhe fjalja e tretë e paragrafit 3, të nenit 65 janë të pandashme dhe në unitet me njera tjetrën. Është ky unitet që bën të mundur që të drejtat dhe detyrimet e partive pjesëmarrëse në koalicion të mos shuhen. Ato mund të transferohen tek partia*

udhëheqëse e koalicionit, por që ky transferim të jetë detyruar për KQZ-në, ai duhet të jetë i shprehur qartë dhe pa ekuivoke në marrëveshjen e koalicionit. Praktika zgjedhore e palëve të interesuara, të cilat në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, kanë qenë të inkuadruara në koalicione është zhvilluar nëpërmjet marrëveshjeve të koalicionit tejet lakonike, të cilat kanë pasqyruar dakordësinë për ekstremitetet e koalicionit (emërtimi, partitë pjesëmarrëse, autorizimi i përfaqësimit), por nuk kanë rregulluar në thelb marrëdhëniet midis partive pjesëmarrëse në koalicion, sidomos sa i takon të drejtave dhe detyrimeve ndaj njeri tjetrit dhe ndaj autoriteteve publike, modaliteteve dhe procedurave të përfaqësimit, raportimin dhe llogaardhënien etj. Kjo praktikë zgjedhore në lidhjen e marrëveshjeve të koalicionit nuk është në koherencë me përcaktimin e paragrafit 3, të nenit 65 të Kodit Zgjedhor dhe dëmton jo vetëm sjelljen në përputhje me ligjin të partive udhëheqëse dhe të partive pjesëmarrëse në koalicione, por edhe pengon zbatimin harmonik dhe pa konflikte të brendshme të detyrimeve ligjore nga koalicionet, në zgjedhje dhe rreth tyre. KAS-i e sheh ligjërisht të mundur dhe i rekomandon KQZ-së, që në ndihmë të subjekteve zgjedhore dhe në zbatim të kompetencës për unifikimin e praktikës zgjedhore të hartojë udhëzime ndihmëse të detajuara për lëndën që duhet të mbulojnë marrëveshjet e koalicionit, me qëllim që ato të jenë ezauruese dhe në harmoni me paragrafin 3, të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, pa ndërhyrë në lirinë e partive politike që të përcaktojnë vetë konturet e bashkëpunimit në koalicion.

16.12 Duke e parë praktikën zgjedhore të koalicioneve nga këndvështrimi i çështjes objekt shqyrtimi, konstatohet lehtë se në akmmarrëveshjet e bashkëpunimit midis Komisionerit dhe partive politike që përfitonin financim buxhetor në zgjedhje (shih vendimin e Komisionerit nr. 172, datë 23.03.2021), këto të fundit i pranonin fondet kundrejt zotimit për t'i përdorur ato "në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 28.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar" (pika 1, e nenit 3 të akmmarrëveshjes tip). Në mënyrë të shprehur ato zotoheshin të respektonin "të gjitha ndalimet dhe kufizimet" që përcaktohen në Kodin Zgjedhor (pika 3, e nenit 3 të aktmarrëveshjes tip), si dhe pranonin "auditimin e fondeve dhe të shpenzimeve të fushatës zgjedhore sipas nenit 92/6 të Kodit Zgjedhor, si dhe monitorimin e aktivitetit gjatë fushatës zgjedhore dhe 4 muaj para datës së zgjedhjeve sipas nenit 92/4 të Kodit Zgjedhor, pavarësisht faktit nëse regjistrohen më vete si subjekt zgjedhor apo në kuadër të një koalicioni zgjedhor" (neni 6 i akmmarrëveshjes tip). Asnjë nga këto zotime nuk ndodhen të transkriptuara në marrëveshjet e koalicionit të lidhura në kuadër të zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021.

16.13 Në vlerësimin e KAS-it, kjo do të thotë se palët nuk kanë pasur qëllim dhe nuk kanë realizuar në fakt transferimin e këtyre detyrimeve/zotimeve nga partitë pjesëmarrëse tek partia udhëheqëse dhe se pretendimi i shprehur në seancë përpara KAS-it se përgjegjësia për raportimin duhet të mbetet me partinë udhëheqëse të koalicionit nuk ka bazë ligjore.

16.14 Ky pretendim rrëzohet edhe nga analiza kronologjike e ngjarjeve. Partitë politike pjesëtare në koalicione janë sjellë si mbartëse të detyrimit përgjatë gjithë hapave të

procesit të raportimit dhe e kanë ngritur pretendimin vetëm në fund të tij, në momentin kur janë mbajtur përgjegjëse për shkelje ose mangësi në raportim. ... Subjektet zgjedhore Partia Socialiste, Partia Demokratike, Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, Lëvizja e Legalitetit, Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë, Nisma Thurje, **Bindja Demokratike**, Partia Socialdemokrate dhe Balli Kombëtar rezultojnë e provuar se kanë pasur mungesa në raportimin e kandidatëve të tyre, të cilat shkojnë, sipas rastit, nga 1 (një), deri në 153 (njëqind e pesëdhjetë e tre) kandidatë. Komisioneri ka kërkuar për këto parti vendosjen e sanksionit. KAS-i çmon se kërkesa e Komisionerit duhet të pranohet dhe sanksioni të mbahet për të gjitha subjektet në minimumin ligjor (pa proporcionalizuar masën), për të prioritetizuar qëllimin edukativ të masave administrative në këtë rast”.

17. Pala paditëse Partia Bindja Demokratike pasi është bërë me dije me vendimin e KAS, duke pretenduar se ky vendim është i pabazuar në ligj dhe në prova, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me padinë objekt gjykimi, duke pretenduar se:

17.1 Partia Bindja Demokratike (BD) është vënë në dijeni në datë 25.01.2023 në lidhje me vendim e Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve nr 07/2023 ku në bazë të pikës 1 të këtij vendimit kjo parti është gjobitur me masën administrative në shumë 500,000 (lekë) së bashku me disa parti të tjera. Shkelja e pretenduar në këtë rast është për shkak se sipas vendimit të KAS Partia Bindja Demokratike nuk ka paraqitur raportet financiare të 153 kandidatëve të saj në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 dhe duke u bazuar në nenin 173/3 të Kodit Zgjedhor është gjobitur me një gjobë prej 500.000 lekë.

17.2 Ky vendim kundërshtohet si i pabazuar në ligj dhe në fakt sepse vërtetë Kodi Zgjedhor kërkon dhe ngarkon me detyrimin për të paraqitur raportet financiare të kandidatëve të saj partinë politike por: Kur kandidatët provohet të kenë kryer shpenzime dhe të kenë siguruar të ardhura dhe partia politike nuk i ka deklaruar këto shpenzime dhe të ardhura. Propozimi i Komisionerit për gjobitjen e Partisë Bindja Demokratike është bërë me arsyetimin se kjo parti nuk ka deklaruar shpenzimet dhe të ardhurat e kandidatëve pa vërtetuar se ata kanë bërë të tilla dhe nuk janë deklaruar. Pra shkelja në këtë rast është vetëm për mosplotësim të kërkesës formale për deklarim, jo se është vërtetuar se kandidatët tanë kanë bërë shpenzime dhe ato janë mbajtur të fshehta prej tyre dhe prej Partisë Bindja Demokratike. Ky është një arsyetim dhe interpretim i gabuar i ligjit, se vërtetë ligji ngarkon me detyrën e deklarimit të shpenzimeve dhe të ardhurave të kandidatëve të saj partinë politike, por kjo vetëm në rastin kur kandidatët kanë bërë shpenzime dhe ato janë mbajtur të fshehta, jo kur subjektet janë para rastit që kandidatët nuk kanë bërë asnjë shpenzim të deklarueshem dhe nuk provohet se kanë pasur ndonjë të ardhur. Se në këtë rast këto deklarime mungojnë sepse nuk ka pasur se çfarë të deklarohet, jo se janë mbajtur të fshehta këto shpenzime.

17.3 Në referim të përcaktimit të neneve 78, 92/3 të Kodit Zgjedhor (ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.7.2012 dhe me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020) rezultojnë se partia

politike ka për detyrim të deklarojë shpenzimet dhe të ardhurat e çdo forme të kandidateve të saj, por nuk ngarkohet me detyrim për të deklaruar shpenzime apo të ardhura të kandidatëve kur ata nuk kanë pasur të tilla. Propozimi i Komisionerit nuk provon se kandidatët e Bindjes Demokratike kanë realizuar shpenzime apo kanë siguruar të ardhura për fushatën elektorale dhe këto shpenzime e të ardhura nuk janë deklaruar nga partia në këtë rast. Ai kërkon ndëshkimin e partisë politike apriori vetëm pse nuk ka një formular deklarimi për shpenzimet dhe të ardhurat e secilit kandidat, pa provuar dhe pa pretenduar se këta kandidatë kanë pasur shpenzime dhe të ardhura.

17.4 Subjekti palë paditëse pretendon se e ka përmbushur këtë detyrim ligjor sepse, ka paraqitur në faqen e fundit të modelit të raportimit në KQZ, ku kërkohej raportimi i shpenzimeve të kandidatëve, shpenzimet e kandidatëve të saj në të gjithë qarqet e Shqipërisë, që në këtë rast ka qenë 0 lekë. Sikurse edhe disa prej rubrikave të tjera të formatit të KQZ janë plotësuar me vlerën 0 për shkak se nuk ka pasur asnjë gjë për të raportuar për atë rubrikë, kështu ka ndodhur dhe në rastin e kandidatëve, të cilët partia i ka deklaruar me shpenzime 0 lekë. Në sqarimin e propozimit të Komisionerit për gjobitje, sekretari i përgjithshëm i KQZ ka deklaruar se gjoba është marrë për shkak të mosdeklarimit të shpenzimeve të kandidatëve të Bindjes Demokratike dhe jo se administrata e KQZ ka vërtetuar shpenzime të padeklaruar nga këta kandidatë. Në këto kushte deklarimi prej 0 shpenzime nga ana e kandidatëve të Bindjes Demokratike në faqen e fundit të formularit tip të deklarimit të shpenzimeve të Partisë Bindja Demokratike për zgjedhjet e vitit 2021, plotëson kërkesën ligjore dhe rrëzon pretendimin e shkeljes nga ana e KAS se kandidatët e Bindjes Demokratike nuk kanë përmbushur detyrimin për deklarimin e shpenzimeve të tyre në fushatë elektorale. Deklarimi me 0 lekë shpenzime dhe të ardhura për kandidatët tanë në thelb është një deklaram që përmbush kërkesën formale për deklarim. Pavarësisht se në këtë rast deklarimi është bërë me 0 lekë shpenzime dhe të ardhura për të gjithë kandidatët e Bindjes Demokratike, ai është një deklaram i rregullt sepse pasqyron të vërtetën.

17.5 Gjithsesi fakti që në raportin financiar të dorëzuar nga Bindja Demokratike shpenzimet e kandidatëve të saj janë deklaruar me zero, nuk do të thotë se të gjithë kandidatët e saj nuk kanë bërë asnjë shpenzim financiar për fushatën e tyre elektorale, por sepse siç u sqarua edhe në mbledhjen e KAS, Bindja Demokratike, për të lehtësuar deklarimin e shpenzimeve të saj financiare, të gjitha shpenzimet i ka deklaruar nëpërmjet daklarimit të shpenzimeve të Partisë.

17.6 Kjo ka ndodhur në këtë mënyrë: Kandidatët e subjektit PBD/palë paditëse të gjithë kontributin financiar që kanë planizuar të shpenzonin për fushatë e kanë derdhur pranë arkës së Partisë. Janë rreth 10 kandidatë të Bindjes Demokratike në zgjedhje që kanë kontribuar me shuma financiare në favor të Partisë, gjë që është deklaruar në raportin financiar të Bindjes Demokratike.

17.7 Më pas, këta kandidatë apo edhe të tjerë, çdo shpenzim financiar që kanë pasur për fushatën e tyre e kanë bërë duke tërhequr lekët pranë arkës së Bindjes Demokratike. Pra në këtë rast çdo shpenzim i kandidatëve është bërë nga arka e Bindjes Demokratike dhe është deklaruar si shpenzim i partisë. Kjo për të lehtësuar raportimin sa më të saktë e të plotë të shpenzimeve në fushatë.

17.8 Sigurisht që në këtë deklaram të Partisë Bindja Demokratike përfshiheshin të gjitha shpenzimet financiare dhe në natyrë që janë të detyrueshme të deklarohen në këtë rast.

17.9 Sa i përket pretendimit të KAS se është e pamundur që një kandidat të mos ketë asnjë shpenzim në fushatë sqarohet se ky arsytim nuk është i saktë sepse: -KAS konsideron shpenzime edhe ato shpenzime të cilat janë të padeklarueshme në këtë rast. -Shpenzimet e deklarueshme sipas Kodit Zgjedhor dhe akteve të tjera nënligjore janë dy llojse, ose financiare ose në formën e kontributit në natyrë. -Të gjitha shpenzimet e tjera nuk janë të deklarueshme sepse nuk përfshihen as në shpenzime financiare dhe as në shpenzime në natyrë. Për të gjitha këto arsye, kërkohet pranimi i kërkesëpadisë sipas objektit të saj.

18. Pala e paditur Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në seancën gjyqësore në datë 09.03.2023, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, ka paraqitur prapësime, duke parashtruar këto shkaqe për rrëzimin e kërkesë padisë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 07, datë 25.01.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve "Për shqyrtimin e kërkesës nr. 04, datë 14.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve":

18.1 Në vendimin nr. 224, datë 07.12.2022 "Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet 2021" të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në raportin financiar të dorëzuar jo në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore, rezulton se:

18.2 *Subjekti/Partia Bindja Demokratike nuk ka dorëzuar raportet për 153 (njëqind e pesëdhjetë e tre) kandidatë të listave shumë-mërore duke mos respektuar vendimin nr. 13, datë 6 prill 2021, të Komisionit Rregullator dhe për këtë arsye nuk janë audituar raportet e kandidatëve, si dhe nga konstatimet e KRIIK rezulton se 12 (dymbëdhjetë) nga këto kandidat kanë pasur shpenzime për reklama politike në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram. Referuar nenit 173, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar Paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja dënohet me gjobë në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) deri 1 000 000 (një milion) lekë";*

18.3 Për sa më sipër, pretendimi i palës paditëse për fushatë të kandidatëve "pa shpenzime" është një pretendim jo real, i cili mund të vijë nga padija, paaftësia për të ruajtur disiplinë financiare apo për të organizuar siç duhet punën, por mund të vijë edhe si tentativë për mosraportim të saktë, për fshehje apo devijim të një pjese të të ardhurave dhe shpenzimeve në kanale informale, apo si shmangie nga tavanet ligjore etj.

18.4 Pavarësisht nga motivet, pretendimi për kandidatë "pa shpenzime" nuk mund të pranohet, sepse një pretendim i tillë është *de facto* i pavërtetë.

II. ARSYETIMI I KOLEGJIT:

19. Referuar shkakut të padisë, rezulton se Partia Bindja Demokratike (sikundër edhe disa parti të tjera), janë proceduar administrativisht për shkelje të detyrimeve që burojnë nga ligji, lidhur me deklaratimet/raportet financiare mbi të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021.
20. Transparenca në financimin e partive politike në përgjithësi dhe partive pjesëmarrëse dhe fituese në zgjedhje në veçanti, përbën një nga parimet bazë të pluralizmit. Këto çështje rregullohen si nga dispozitat e ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "*Për partitë politike*", ashtu edhe nga Kodi Zgjedhor.
21. Konkretisht parimi i transparencës së financimit të partive politike, parashikohet fillimisht në nenin 15/1 e vijues të ligjit "*Për partitë politike*". Në nenin 15/2 përcaktohet se: "*1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive, sipas rregullave të këtij ligji. 2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bazë dhe për zbatimin e këtij ligji, ka këto kompetenca: a) harton dhe miraton rregullat për raportimin e financimit, për monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin financiar të partive politike, si dhe për formatet e standardizuara për raportimin financiar vjetor; b) miraton formatin e regjistrit të posaçëm të fondeve jopublike të partive politike, si dhe formatin për formën dhe përmbajtjen e deklaratës së dhurimit të fondeve jopublike; c) mban listën e ekspertëve kontabël të licencuar dhe i cakton me short ata për auditimin e fondeve dhe të shpenzimeve të partive politike; ç) monitoron, mbikëqyr dhe auditon financimin e partive politike, nëpërmjet kontrollit të dokumentacionit financiar e të llogarive kontabël të partive politike, të subjekteve të lidhura, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me partitë politike apo që ndodhen nën kontrollin e tyre; d) vendos sanksione kur konstaton shkelje të dispozitave të këtij ligji; dh) harton programe ndërgjegjësuese dhe organizon trajnime për financimin e partive politike dhe të subjekteve të përfshira në këtë proces, sipas dispozitave të këtij ligji; e) përcakton masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore, në përputhje me këtë ligj; ë) nxjerr akte nënligjore në bazë dhe për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.*"
22. Sikurse konstatohet, kompetenca e KQZ-së për të normuar, monitoruar dhe sanksionuar shkeljet në fushën e financimit të partive politike, buron para së gjithash nga ligji i sipërcituar. Në vijim, i njëjti ligj parashikon edhe se si financohen partitë politike nga buxheti i shtetit, duke marrë për bazë edhe pjesëmarrjen dhe suksesin në zgjedhje.
23. Konkretisht në nenin 19 përcaktohet se: "*1. Çdo vit në Buxhetin e Shtetit përcaktohet një fond që shërben si ndihmë financiare publike për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive*

politike. Ndhimja financiare e parashikuar në Buxhetin e Shtetit në vitet jozgjedhore, si rregull, nuk mund të jetë më e vogël se ndihma e parashikuar në vitin paraardhës. 2. Ky fond ndahet sipas rregullave të mëposhtme: a) 70 për qind, sipas numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Çdo parti parlamentare përfiton ndihmë financiare në përputhje me numrin e deputetëve që ka fituar në bazë të sistemit zgjedhor të parashikuar në Kodin Zgjedhor; b) 20 për qind, në mënyrë të barabartë, ndërmjet partive parlamentare dhe partive që kanë marrë mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare. c) 10 për qind, sipas përqindjes së fituar ndërmjet partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1 për qind të votave në shkallë vendi. Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10-përqindëshi i shtohet fondit prej 70 për qind dhe u ndahet 5 partive parlamentare. 3. Masa konkrete e fondit publik, që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore, në përputhje me këtë ligj, përcaktohet me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky vendim u njoftohet partive politike përfituese dhe Ministrisë së Financave. 4. Ndhimja financiare vjetore, në çdo rast, jepet vetëm nëse partia politike ka dorëzuar, paraprakisht, raportin financiar të vitit paraardhës, sipas rregullave të përcaktuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Mosdorëzimi i këtij raporti përbën shkak për përjashtimin e partisë politike nga përfitimi i ndihmës financiare vjetore. 5. **Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që përcakton masën konkrete të fondit publik për çdo parti politike, mund të ankimohet në gjykatë, në përputhje me rregullat për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.**”

24. Së fundi, pasi përcaktohen detyrimet konkrete të partive politike lidhur me mbajtjen e dokumentacionit financiar dhe raportimin një herë në vit pranë KQZ-së, në nenin 23/2, pika 6 përcaktohet se: “6. Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në këtë ligj nga partitë politike apo dhuruesit, në rast se nuk përbën vepër penale, është kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas parashikimeve të këtij ligji.”
25. Me ndryshimet që i`u bënë këtij ligji në vitin 2020, në të njëjtën kohë kur pësoi ndryshime edhe Kodi Zgjedhor, dispozitat që lidheshin me financimin e fushatës zgjedhore, u shfuqzuan në ligjin “Për partitë politike” dhe u bënë pjesë e Kodit Zgjedhor. Ndërkohë dispozitat e lartpërmendura vijuan të mbeten në tekstin e ligjit “Për partitë politike”.
26. Kjo zgjidhje e ligjvënësit nuk ndryshoi në thelb as të drejtën e partive politike për të përfituar fonde, përfshirë ato nga buxheti i shtetit, por as kompetencën e KQZ-së për monitorim dhe kontroll financiar. E vetmja arsye, për të cilën një nga aspektet e financimit të partive politike, por edhe të kandidatëve që mbështeten nga zgjedhësit, u përfshi në rregullimin e Kodit Zgjedhor, lidhet me një procedurë të posaçme, atë të transparencës së financimit të fushatës zgjedhore, në kuadër të kompetencës themelore për kontroll financiar. Këtu mbahet parasysh se transparenca e financimit të partive politike, u rregullua në Kodin Zgjedhor sepse përveç cilësisë si parti politike, këto të fundit mbajnë përkohësisht edhe cilësinë e subjektit zgjedhor, për shkak të pjesëmarrjes në proces dhe përfitimit edhe për këtë arsye të fondeve publike. Në funksion të qëllimit për të garantuar ndershmërinë e

subjekteve zgjedhore dhe për rrjedhojë edhe të vetë procesit zgjedhor, ligjvënësi pa të arsyeshme që kontrolli financiar i fushatës zgjedhore, të rregullohet nga Kodi Zgjedhor.

27. Për këtë arsye, ligjvënësi bëri pjesë të Kodit Zgjedhor, normat që deri para ndryshimit të vitit 2020, ishin pjesë e ligjit “Për partitë politike”.
28. Parimi i transparencës financiare parashikohet kështu edhe në dispozitat e Kodit Zgjedhor. Neni 3, pika 5/1 i këtij Kodi përcakton se: “Subjektet zgjedhore përfitojnë financime publike dhe jopublike në mbështetje të fushatës së tyre, sipas dispozitave ligjore përkatëse. Subjektet zgjedhore bartin detyrimin për transparencë dhe publikim të të ardhurave dhe shpenzimeve në zgjedhje kundrejt KQZ-së, personave të ngarkuar me auditimin apo monitorimin dhe publikut.”
29. Referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor, mbi financimin dhe monitorimin e financimit të partive politike gjatë fushatës zgjedhore, rezulton se në kuadër të kompetencës, që KQZ ka, për të garantuar transparencën e financimit të partive politike, zhvillohet një procedurë e posaçme për subjektet që kanë marrë pjesë në zgjedhje, pas përfundimit të tyre dhe shpalljes së rezultatit. Të gjitha partitë politike që kanë marrë pjesë në zgjedhje, kanë detyrimin që brenda një afati prej 60 ditë nga shpallja e rezultatit, të depozitojnë në KQZ raportin financiar për shpenzimet e fushatës zgjedhore.
30. Kundërvajtjet administrative të parashikuara nga neni 173 i Kodit Zgjedhor, që lidhen me mospërbushjen e detyrimeve në këtë fushë, janë të njëjta për sa i përket natyrës së shkeljeve, me ato të parashikuara nga ligji “Për partitë politike”.
31. Nisur nga sa më sipër, shtrohet për diskutim çështja nëse vendimet e KQZ-së për konstatimin dhe ndëshkimin e një kundërvajtje administrative në fushën e financimit të partive politike dhe përbushjes së detyrimeve nga partitë që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit, objekt monitorimi dhe kontrolli, janë apo jo në lëndën e mosmarrëveshjeve që shqyrtohen nga KZGJ, apo ankimet kundër vendimeve për këto kundërvajtje administrative, do të ndjekin rrugën e zakonshme të gjykimit administrativ?
32. Paraprakisht evidentohet fakti se, në mjaft raste të praktikës së mëparshme të Kolegjit Zgjedhor, ky i fundit ka mbajtur qëndrimin se kundërvajtjet administrative dhe mosmarrëveshjet që lindin për shkak të tyre, në kuadër të zbatimit të dispozitave të Kodit Zgjedhor, janë në kompetencë të gjykatës administrative.
33. Ky qëndrim i KZGJ-së, i referohet së pari natyrës së posaçme të gjykatës së zgjedhjeve, e krijuar nga ligji me qëllim shqyrtimin e mosmarrëveshjeve, që lindin përgjatë një procesi zgjedhor (zgjedhje për Kuvendin, ato vendore apo referendumet). Është kjo arsyeja për të cilën, KZGJ mblidhet jo më vonë se 50 ditë përpara datës së zgjedhjeve dhe qëndron i mbledhur deri në përfundim të gjykimit të ankimeve ose të kalimit të afatit të ankimeve për procesin zgjedhor, sikurse mblidhet 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjeshme dhe referendumet dhe, qëndron po ashtu i mbledhur deri në përfundim të shqyrtimit të ankimeve për këto procese (shih nenin 147 të Kodit Zgjedhor).

34. Vetë struktura e Kodit Zgjedhor tregon se objekt i ankimeve gjyqësore në KZGJ do të jenë ato çështje, që shqyrtohen fillimisht sipas Pjesës X të Kodit Zgjedhor titulluar “*Ankimi në rrugë administrative i vendimeve të komisioneve zgjedhore*”. Është pikërisht kjo pjesë e Kodit Zgjedhor që trajton ankimet zgjedhore, ngritjen e një regjistri të posaçëm për to, formën dhe përmbajtjen e ankimit zgjedhor, rregullat procedurale për shqyrtimin administrativ dhe vendimin që merret në përfundim të procesit.
35. Pas pjesës X të Kodit Zgjedhor vjen Pjesa XI, që rregullon ankimet në rrugë gjyqësore të vendimeve të KQZ-së dhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Nga përmbajtja e Kreut I të kësaj pjese, si dhe në lidhje logjike me Kreun X, qartazi kuptohet se në fushën e kompetencës së KZGJ-së, bëjnë pjesë vetëm ankimet gjyqësore, kundër vendimeve të KQZ-së që lidhen me procesin zgjedhor përkatës dhe të referuara nga subjektet e posacme. Kështu, Kodi Zgjedhor përcakton, të njëjtën gjë sikurse edhe në rastin e ankimit administrativ ndaj vendimeve të komisioneve zgjedhore (neni 124 i Pjesës X), se subjektet që legjitimohen të paraqesin ankimet e tyre në KZGJ janë: **1) subjektet zgjedhore; 2) partitë politike ose kandidatët e mbështetur nga zgjedhësit që paraqesin kërkesë për t’u regjistruar si subjekte zgjedhore; 3) subjektet që kërkojnë të akreditohen si vëzhgues në zgjedhje, kur i’u refuzohet një gjë e tillë.** Nga ana tjetër, kompetenca e KAS për vendosjen e sanksioneve administrative, nuk është rrjedhojë e një procesi ankimimi, por ushtrim i kompetencës së caktuar me ligj për të shqyrtuar nëse një kundërvajtje është kryer apo jo, si dhe për të vendosur ndëshkimin përkatës.
36. Duke i’u kthyer ankimeve ndaj vendimeve të komisioneve zgjedhore, me përfundimin e zgjedhjeve dhe shqyrtimin e ankimeve zgjedhore, subjektet zgjedhore pushojnë së qeni të tilla dhe vijojnë të jenë thjesht parti politike (ato mund të jenë parti politike parlamentare ose jo, në varësi të rezultatit që kanë marrë në zgjedhjet pararendëse). Po ashtu, pas përfundimit të zgjedhjeve, nuk mund të ketë as ankime për refuzim të akreditimit të vëzhguesve, pasi nuk ka një proces zgjedhor (*ai ka përfunduar*).
37. Për rrjedhojë, me mbylljen e procesit zgjedhor, shpalljen e rezultatit dhe përfundimin e afatit të ankimeve, përfundon edhe procesi i shqyrtimit në rrugë gjyqësore të çështjeve zgjedhore. Veprimtaria e KZGJ-së mundet eventualisht të vijojë edhe pas përfundimit të procesit të ankimeve, kur shpallet pavlefshmëria e zgjedhjeve dhe ato përsëriten në një apo disa zona zgjedhore (shih nenin 161 të Kodit Zgjedhor). Në këtë rast, do të priten edhe ankimet e mundshme pas përsëritjes së zgjedhjeve.
38. Nisur nga sa më sipër, KZGJ edhe në rastet e tjera të ngjashme kur i janë paraqitur ankime gjyqësore ndaj vendimeve që konstatojnë dhe ndëshkojnë kundërvajtje administrative, të kryera këto edhe nga subjekte, që e kanë mbajtur cilësinë e subjektit zgjedhor, nuk i ka konsideruar në fushën e tij të kompetencës.
39. Kompetencat e KZGJ-së jo vetëm që nuk përfshijnë shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lidhen me kundërvajtjet e kryera sipas Kodit Zgjedhor, por KZGJ nuk shqyrton as çështje që kanë ndikim në vijimësinë e një mandati të fituar në zgjedhje, siç janë rastet e vendimeve

të KQZ-së për pavlefshmërinë e mandatit të të zgjedhurve, që kanë impakt të drejtpërdrejtë në listat e kandidimit, me të cilat një subjekt zgjedhor ka marrë pjesë në zgjedhje. Në një prej rasteve kur është vënë në diskutim çështja e kompetencës lëndore mes gjykatës administrative dhe Kolegjit Zgjedhor, ndërsa gjykata administrative arsyetonte se janë në kompetencë të Kolegjit Zgjedhor të gjitha vendimet e KQZ-së që cenojnë të drejtat e subjekteve zgjedhore, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, e gjeti të pabazuar këtë qëndrim (shih vendimin nr. 667, datë 08.05.2018 të Gjykatës së Lartë). Ndër të tjera, Kolegji Administrativ arsyeton se: *“...Një nga kategoritë e mosmarrëveshjeve administrative që ligjvënësi e ka përjashtuar nga fusha e shqyrtimit të gjykatave administrative janë ato që burojnë nga vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në kuadër të procesit zgjedhor. Mbështetur në analizën e bërë më sipër kompetenca lëndore e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë, shtrihet vetëm për mosmarrëveshjet që lindin nga procesi zgjedhor (kundërshtimi i vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me administrimin e procesit zgjedhor). Asnjë mosmarrëveshje tjetër, qoftë edhe kur buron nga vendimmarrja e këtij organi publik (Komisionit Qendror të Zgjedhjeve), por jo në kuadër të procesit zgjedhor, nuk mund t'i atribuohet kompetencës lëndore të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë. Pra, kompetenca e saj, duke qenë ekskluzive, duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë dhe fokusohet vetëm në mosmarrëveshjet zgjedhore, të ngritura nga subjektet zgjedhorë. ...”*.

40. Nisur nga sa më sipër, në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, që kufizojnë kompetencën e KZGJ-së vetëm në shqyrtimin e ankimeve, lidhur me procesin zgjedhor, arrihet në përfundimin se çdo mosmarrëveshje tjetër e KQZ-së, që nuk lidhet me këtë proces, por me ushtrimin e funksioneve publike të ngarkuara me këtë Kod dhe me ligje të tjera të vecanta, nuk bëjnë pjesë në fushën e kompetencës së kësaj gjykate, por duhet të ankimohen në rrugën e zakonshme në gjykatën administrative.
41. Si përfundim, ky Kolegj vlerëson se çështja e paraqitur nga Partia Bindja Demokratike është në kompetencë lëndore dhe tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
42. Në referencë të përcaktimeve të neneve 158 të Kodit Zgjedhor, duke qenë se Kolegji konstaton mungesë kompetence lëndore, disponon me vendim për pushimin e gjykimit të kërkesëpadisë së ngritur nga Bindja Demokratike. Në zbatim të nenit 158/2 i Kodit Zgjedhor, Kolegji vlerëson dërgimin e akteve për shqyrtim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenet 158, 159 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Pushimin e gjykimit të çështjes nr.2 regj.them., datë 24.02.2023 Regj.Them.
2. Dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
3. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

U shpall sot në Tiranë, në datë 09.03.2023.

GJYQTARE	GJYQTAR	GJYQTARE	GJYQTARE	GJYQTARE
Marsela DERVISHI	Sokol IBI	Blerona HASA	Edlira PETRI	Emona MUÇI
(kundër)		(kundër)		